



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR



Nr. 16906 Prot

Shkodër, më 19.11.2020

Lënda: Kërkesë për pajisje me Akt Përputhshmërie në kuadër të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër

AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT ✓
Rruga: “Muhamet Gjollësia”, Nr.57, Tiranë

Bashkia Shkodër ka të miratuar dhe në fuqi aktualisht Planin e Përgjithshëm Vendor me vendimin Nr. 19, datë 24.03.2017 të Këshillit Bashkiak Shkodër dhe Vendimin Nr. 5, datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Pas miratimit të këtij Plani Bashkia Shkodër ka monitoruar zbatimin e tij në vazhdimësi dhe ka ndërmarrë nismën për rishikimin e tij për disa arsye të cilat janë trajtuar në dokumentin e nismës së rishikimit të PPV-së.

Në zbatim të nenit 23, pika 14 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 13, pika 1, shkronja “b”, neneve 23, 24, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neneve 10, 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar si dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 22.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar”, **Bashkia Shkodër** ka kryer procesin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për territorin e saj administrativ.

Në vijim, bazuar në nenin 9, pika 2, nenin 13, pika 1, shkronja “d”, nenet 23 dhe 25 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Nenit 2, pika 2, neneve 5, 6 dhe 8, nenit 60, pika 3, shkronja “a”, nenit 62, pika 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, kërkojmë nga AKPT lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Shkodër

Bashkëlidhur gjeni relacionin e dokumentit të rishikimit të PPV Bashkia Shkodër.

Me respekt,

